



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Brendshme
Nr. Prot. 4199 dt. 23.06.2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave
Nr. Prot. 1623 dt. 23.6.2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Drejtësisë
Nr. Prot. 5897 dt. 23.06.2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Prokuroria e Përgjithshme
Nr. Prot. 2695 dt. 23.06.2010

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Në kuadër të koordinimit ndërkombëtar për zbatimin e ligjit

Të vetëdijshëm për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe nderkombëtar në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti;

Duke patur parasysh faktin se në axhendën e këtyre institucioneve dhe agjensive të zbatimit të ligjit të varesisë, lufta dhe bashkëpunimi rajonal/nderkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar dhe të gjitha formave të trafikimit të qënieve njerëzore, luftën kundër terrorizmit, janë përcaktuar si prioritet kryesor;

Duke njohur faktin se natyra transnacionale e krimit të organizuar dhe lidhjet mes krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit bëjnë të nevojshëm ndërmarrjen e veprimeve si rajonale ashtu dhe nderkombëtare;

Të ndërgjegjshëm për faktin se bashkëpunimi rajonal/nderkombëtar në fushën e hetimit dhe të ndjekjes penale përbën një kontribut të rëndësishëm dhe vendimtar në përpjekjet për rritjen e efikasitetit të luftës kundër krimit të organizuar;

Me dëshirën për të mundur arritjen e synimeve të sipërpërmendura nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë nderinstitucional dhe nderkufitar;

Bien dakort si më poshtë:

I. Forcimi i bashkëpunimit

1. Të bashkëpunojnë mes tyre, përfshirë këtu agjensitë në varesi të këtyre institucioneve, më qëllim arritjen e optimizimit të bashkëpunimit nderkombëtar dhe përmirësimin e proceseve ekzistuese të mbarëvajtjes së punëve, nëpërmjet Drejtorisë së Bashkëpunimit dhe Koordinimit Nderkombëtar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme, pa cenuar mardheniet e këtyre institucioneve me institucionet homologe përtej kufirit.
2. Të rritin shkëmbimin e rregullt të informacionit për të luftuar krimin dhe për të shkëmbyer informacionin përkatës në kryerjen e hetimeve nderkombëtare, duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Të krijojnë një mjedis për një shkëmbim sa më funksional të informacionit në përgjithësi dhe të atij kriminal, në të cilin do të operojë Drejtoria e

Bashkepunimit dhe Koordinimit Nderkombetar, si struktura kryesore per koordinimin e ketij aktiviteti, me qellim qe:

- të koordinojë institucionet ne procesin e shkembimit nderkombetar te informacionit;
- të koordinojë autoritetet kompetente për të mbledhur informacione dhe të dhëna me qëllim lehtësimin e hetimeve ndërkombëtare penale;
- të koordinojë procesin e bashkëpunimit mes institucioneve kompetente dhe partnerëve ndërkombëtarë, me synim përshpejtimin e proceseve hetimore;

II. Menyrat e komunikimit

4. Institucionet dhe agjensite e zbatimit te ligjit ne varesite ketyre institucioneve caktojne pikat e kontaktit (strukture dhe person) per komunikim me Drejtorine e Bashkepunimit dhe Koordinimit Nderkombetar, ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise dhe ia komunikojne kesaj te fundit.
5. Pika e kontaktit komunikojne ne menyre te drejtperdrejte me Drejtorine e Bashkepunimit dhe Koordinimit Nderkombetar, ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise duke informuar drejtuesin e institucionit /agjensise perkatese.
6. Shkembimi i informacionit behet ne perputhje te plote me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi, si dhe aktet normative te sejcilit prej institucioneve apo agjensive te varesise.

III. Afatet e komunikimit

7. Pikat e kontaktit prane institucioneve dhe agjensive te varesise shkembejne informacionin ne kohe reale sipas prioriteteve: teper urgjent - menjehere; urgjent - brenda 24 oreve; prioritet - brenda tre dite pune; normal - brenda 7 dite pune.

IV. Mjetet e komunikimit

8. Komunikimi mes pika te kontaktit dhe perdorimi i mjeteve te komunikimit kryhet ne perputhje me rregullat ligjore ne fuqi ne lidhje me informacionin e klasifikuar

V. Hyrja ne fuqi

9. Ky Memorandum hyn ne fuqi nga dita e nenshkrimimit.

Nenshkruar ne Tirane, me date 24 Qershor 2010

Ministri i Brendshem
Lulzim Basha
Lulzim BASHA



Prokurori i Pergjithshem
Ina Rama
Ina RAMA



Ministri i Financave
Ritvan Bode
Ritvan BODE



Ministri i Drejtësisë
Bujar Nishani
Bujar NISHANI

